

POLITIKAT E ICMP PËR PËRPUNIMIN DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Definicionet

- a. "Mostrat biologjike" i referohen çdo mostre të materialit biologjik (për shmebull gjaku dhe qelizat e eshtrave) në të cilat është i pranishëm acidi nukleik dhe të cilat përmbajnë karakteristikat gjenetike të bartësit të të dhënave.
- b. "Pëlqimi" i referohet vërtetimit të lirë dhe informativë të bartësit të të dhënave me të cilin ai lejon përdorimin e të dhënave të tijë/sajë personale për qëllim specifik për të cilin të dhënat parashikohen të përdoren në bazë të informacioneve të ofruara në kohën kur janë dhënë të dhënat personale.
- c. "Mbledhja" e të dhënave i referohet kërkesës së bërë bartësit të të dhënave për të ofruar të dhëna personale dhe për ti regjistruar ato.
- d. "Përpunimi i të dhënave" i referohet çdo operacioni ose një sërë operacionesh të cilëve të dhënat personale i nënshtrohen, derisa janë nën kontroll të ICMP, përfshirë edhe mbledhjen e të dhënave, regjistrimin, inçizimin, përdorjen, transferimin, bartjen dhe ndarjen, "ngrirjen" ose fshirjen.
- e. "Sistemi i përpunimit të të dhënave" i referohet strukturimit të të dhënave personale të cilat janë të disponueshme në bazë të kriterëve të përzgjedhjes.
- f. "Pranuesi i të dhënave" i referohet personit fizik apo juridik të cilit i janë dhënë të dhënat personale.
- g. "Bartësi i të dhënave" i referohet personit fizik apo juridik i cili mundë të identifikohet në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat personale.
- h. "I punësuar" i referohet secilit person i cili paguhet nga ICMP, dhe është i punësuar me orar të plotë të pjeshëm apo është praktikant.
- i. "Të dhënat personale" i referohet çdo informacioni në lidhje me personin fizik.
- j. "Shënime" i referohet çdo dokumenti, korrespondencën, letra origjinale, hartë, vizatim, tabelë, indeksi, plani, memorandumet, regjistrimet e zërit, mikrofilm, foto në lëvizje ose të dhënat tjera fotografike apo materiale në posedim apo nën kontrollin e ICMP duke përfshirë të dhënat e gjeneruara në mënyrë elektronike apo kompjuterike, bazat e të dhënave dhe të sistemeve të përpunimit të të dhënave për përcaktimin, krijimin, manipulimin, kontrollin, menaxhimin, dhe përdorimin e bazave të të dhënave dhe të sistemit që kontrollon, organizimin, dhe modifikimin e një bazë të dhënash dhe qasje në të dhënat e ruajtura brenda saj.
- k. "Të dhënat personale të ndjeshme" i referohet të dhënave personale që tregojnë racën, prejardhjen etnike, fetare, bindjeve filozofike ose politike të bartësit të të dhënave, ose të shëndetit, ose jetën seksuale të bartësit të të dhënave, si dhe të dhëna për karakteristikën gjenetike make-up e bartësit të të dhënave dhe të dhënat në lidhje me ndjekje penale dhe dënimeve.

2. Zbatueshmëria

- a. Këto politika aplikohen për të punësuarit e ICMP.

- b. Për qëllime të këtyre Politikave, mostrat biologjike dhe të dhënat që rrjedhin nga mostra të tilla do të konsiderohen të dhëna të ndjeshme personale në bazë të nenit 3 (3) më poshtë.

3. Politikat

1. Është politikë e ICMP të mbrojtë të dhëant personale nga përpunimi i pautorizuar.
2. Të dhënat personale, përveç të dhënave të ndjeshme personale, mund të përpunohen, me kusht që përpunimi i tillë është i mandatuar nga qëllimet dhe funksionet e ICMP-së, dhe nuk ka dispozita të kundërta në bazë të marrëveshjeve ose angazhime të tjera të detyrueshme që ICMP ka arritur në ushtrimin e qëllimeve dhe funksioneve të tijë, dhe së paku të jetë i pranishëm një nga kushtet e mëposhtme:
 - a. Bartësi i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tijë/sajë;
 - b. Përpunimi i të dhënave është në përputhje me një interes të madh publik dhe është në përputhje me të drejtat e bartësit të të dhënave në fjalë;
 - c. Përpunimit i të dhënave është i domosdoshëm për nevojat e kërkimit shkencor ose statistikorë dhe nuk shkelin të drejtat e bartësit të të dhënave në fjalë, si e drejta për privaci.
3. Përpunimi i të dhënave të ndjeshme personale lejohet për një nga arsyet e mëposhtme:
 - a. Bartësi i të dhënave ka ofruar pëlqimin e tijë të shprehur me shkrim për përpunimin e të dhënave të ndjeshme personale të tijë/sajë. Në mungesë të nënshkrimit, bartsi i të dhënave mundë të përdorë gjurmën e gishtrinjeve pasi ti është lexuar pëlqimi atijë dhe të jetë nënshkruar nga dëshmitari;
 - b. Është e domosdoshme të mbrohet jeta dhe shëndeti i bartësit të të dhënave ose personit tjetër, dhe bartësi i të dhënave nuk është juridikishtë apo fizikishtë i aftë për të dhënë pëlqimin;
 - c. Është e domosdoshme, si pjesë e hulumtimeve shkencore ose statistikore dhe e dobishme për arritjen e qëllimeve dhe funksionit të ICMP, që të dhënat e ofruara të përpunohen në atë mënyrë e cila është në pajtueshmëri të plotë me të drejtat e personit në fjalë dhe të ndaqhen në mënyrë të përhershme të dhënat e ndjeshme personale nga të dhënat tjera të cilat do të lejonin identifikimin e bartësit ose bartësve të të dhënave në fjalë;
 - d. Të dhënat janë në domenin publik;
 - e. Në rastet kur pëlqimi mund të zëvendësohet nga procedurat e nevojshme ligjore sipas ligjeve vendore, të tilla si me urdhër të një gjykate, ICMP-ja mund të pranojë procedurat e tilla në vend të pëlqimit nga bartësi i të dhënave në fjalë me kusht që ICMP mund të konstatojë besueshëm se procedurat e tilla janë në përputhje me një interes të madh publik dhe janë në përpjesëtim me të drejtat e personave të interesuar.
4. Kur merren të dhënat nga bartësi i të dhënave, bartësit të të dhënave duhet ti jipet adresa dhe koordinatat tjera të ICMP, emir i mbledhësit të të dhënave të ICMP-së si dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave. Bartësi i të dhënave duhet të informohet gjithashtu, edhe me pranuesin e të dhënave dhe të drejtat e bartësit të të dhënave për të patur çasje për të plotësuar apo edhe tërhequr të dhënat e tijë/sajë.
5. Të dhënat duhet përpunuar në atë mënyrë e cila siguron se të dhënat janë të sakta, të azhornuara korigjuara ose fshira me kohë.
6. Të dhënat personale mundë të ju jipen palëve të treat me pëlqimin e bartësit të të dhënave, dhe vetëm nëse pala e tretë rrespekton standardet ndërkombëtare të aplikueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Rregulloren e BE-së 95/46/EC.
7. Çdo bartje fizike e të dhënave që përmbajnë të dhëna personale ose mostrat biologjike do të bëhet në kontenerë të shënuar në mënyrë specifike ose të automjeteve, të tilla si automjete diplomatike, për të

siguruar paprekshmërinë e përmbajtjes së tyre në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare. Çdo transferim elektronik i të dhënave personale duhet të jetë i enkriptuar ose me masa tjera mbrojtëse

8. Politikat duhet të zbatohen në përputhje me procedurat standarde operacionale (PSO) për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Të dhënat personale duhet të trajtohen tërë kohës sit ë besueshme dhe duhet të përpunohen në përputhje me politikat e ICMP-së për besueshmërinë. Besueshmëria e rreptë duhet të aplikohet tërë kohës për të dhënat e ndjeshme personale.
10. Masat disiplinore në përputhje me Politikat e Personelit, zbatohen në rast të shkeljes së këtyre politikave.